



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA EKONOMISË, KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 124 Prot

Elbasan më 20.02.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive", të Udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024 Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të Institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit", ne Urdherin nr.2837/1.prot "Per miratimin e numrit te Instruktove dhe Mesuesve me kohe te pjesshme per vitin 2025" protokolluar në "Qendra e Formimit Profesional Publik Elbasan me nr.120.prot ,datë 19.02.2025;

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet:

- Instruktor/e Estetike - 1 person
- Instruktor/e Instalime dhe Mirembajtje rrjeti Elektrik, Instalime te paneleve diellore fotovoltaike - 3 persona
- Instruktor/e Instalime dhe Mirembajtje rrjeti Hidraulik, Mirembajtje paneleve diellore -1 person
- Instruktor/e Kuzhine, Kasap, Perpunim mishi, - 5 persona
- Sherbime ne Bujtina, Sherbim Bar Restoranti, - 1 persona
- Instruktor/e Mobileri - 1 person

- Instruktor/e Parukeri - 4 persona
- Instruktor/e Punime Muratimi Suvatimi, Punime Pllakashtrimi, Hekurkthim , Bojatisje, Punime ndertimi, Karpentieri -1 person
- Instruktor/e Elektroshtepiake -1 person
- Instruktor/e Rrobaqepsi , Rrobaqepsi per Fasoneri - 2 persona
- Instruktor/e Saldim, Punime Duralumini - 1 person
- Instruktor/e Servis Elektroauto ne automjetet e lehta- 1 person
- Instruktor/e Servis Motori ne Automjetet e lehta , Automekanik , Lllamarinist , Bojatisje Automjetesh - 1 person
- Instruktor/e Frutikulture , Kopshtari - 1 person
- Instruktor/e Sherbim Mikpritje Hotelerie - 1 person
- Instruktor/e Instalim dhe Mirembajtje Sistemeve Ngrohje - Ftohje , Instalime dhe Mirembajtje Kondisioneresh - 1 person
- Instruktor/e Marketing Digjital , Aftesi Digjitale Baze- 1 person
- Instruktor/e Berber - 3 persona
- Instruktor/e Manikyr- Pedikyr - 1 persona
- Instruktor/e Ndhimes ne Masazheri - 1 person
- Instruktor/e Sisteme te thata ne ndertesa - 1 person
- Instruktor/e Sekretari - 1 person
- Instruktor/e Prodhime Brumi , Pasticeri , Picajol- 1 person
- Instruktor/e Kujdestari Femijesh - 2 persona
- Instruktor/e Kujdestari per te moshuar, Kujdestari per persona me aftesi te kufizuara ,Kujdestar Social - 1 person
- Gjuhe e Huaj Anglisht (IEVP)- 1 person
- Aftesi Punesimi -1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ,pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën ,në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shendetesore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2.Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3.Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofrunit publik të AFP-së brënda datës 27.02.2025

